



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	12.02.2025	Duke u mbishtetur ne Ligin Nr. 119/2014 "Per te drejten e informimit," dhe në perputhje me nenet e ketij ligi, i cili regullon te drejten e njohjes me informacionin qe prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtohem me kete kerkese për te marre informacionin e meposhtem: A keni konstatuar pesticide nga analizat e vetkontrollit te subjekteve për vitin 2024? Nese po, gfare pesticidesh keni konstatuar dhe në cilal produkte? Në çfaré sasje dhe nga cilat	18.02.2025	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk ofron analiza autokontrolli për mbetjet e pesticideve. ISUV është laborator i cili bazuar ligjit mbi të cilin është i mbështetur ofron analiza lidhur me kontrollet zyrtare në kuadër të planeve dhe programeve të miratuara nga Autoriteti Kompetent. Analiza në kuadër të autokontrollit janë përgjegjësi e OB.	E plote	0

		<p>zona janë produktet? Bazuar në detyrimet ligjore per transparence dhe në të drejten e gytetarëve per tu informuar, presim qe të na mundesoni informacionin e kerkuar brenda slatit te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi. Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin, mbetemi ne pritje te nje pergjigjeje sa me te shpejtë nga ana Juaj.</p>				
2.	21.03.2025	<p>Sipas te dhenave zyrtare ISUV nuk ka mundur të përmbushë sipas afateve ligjore kërkesat e AKU për analiza të përqëndrimit të PMB-ve në produktet e tregut. Institucioni juaj ka realizuar një numër të vogël analizash të mostrave të produkteve pavarësisht kërkesave apo planeve të AKU për monitorimin e tregut për përdorimin e PMB-ve. - Cilat janë</p>	07.04.2024	<p>MBI ANALIZIMIN E PMB-ve NE ISUV - Cilat janë shkaqet që ISUV nuk ka arritur të përmbush në sasi dhe në afat detyrimin ligjor për monitorimin e përdorimit të PMB-ve e produkteve që tregëtohen nëpërmjet testimit?</p> <p>ISUV në kuadër të Planit Kombëtar Të Kontrolleve Zyrtare Me Bazë Risku per cdo vit realizon analizimin e kampioneve te PMB te cilat parashikohen dhe vijne nga AKU .</p> <p>ISUV I ka testuar dhe analizuar brenda afateve ligjore produktet e mbrojtjes se bimeve.</p> <p>- Cilat janë kapacitetet laboratorike të ISUV? - A keni kërkuar ju nga</p>	E Plote	0

		<p>shkaqet që ISUV nuk ka arritur të përmbush në sasi dhe në afat detyrimin ligjor për monitorimin e përdorimit të PMB-ve e produkteve që tregëtohen nëpërmjet testimit?</p> <p>- Cilat janë kapacitetet laboratorike të ISUV?</p> <p>- A keni kërkuar ju nga Ministria e Bujqësisë shtim kapacitetesh laboratorike dhe njerëzore, nëse po çfarë është bërë në këtë drejtim?</p>		<p>Ministria e Bujqësisë shtim kapacitetesh laboratorike dhe njerëzore, nëse po çfarë është bërë në këtë drejtim?</p> <p>Struktura laboratorike në ISUV është funksionale për të mundësuar realizimin e këtyre analizave.</p>		
3.	31.03.2025	<p>Me ndihmoni dot me pergjigjen e analizave te mostrave qe jane marre tek ne</p> <p>Fileto Pule 19 janar 25</p> <p>Fileto pule 27janar25</p> <p>Kofshe pule 18mars25</p> <p>Kofshe pule 28mars25</p> <p>Ju falenderoj parprakisht</p>	01.04.2025	<p>Ju informojme se raportet e proves per kampionet qe ju kerkoni mund ti mare vetem autoriteti i cili i ka sjelle ato kampione per analizim.</p> <p>Ju lutem drejtohuni prane autoritetit i cili ka mare mostrat.</p>	E Plote	0

4.	24.05.2025	Jam nje student dhe kam nje park me rreth 20 koshere me blete dhe isha i interesuar per ti kryer analizat mjaltit. Ju lutem a me shpjegoni si funksionon dhe sa kushton.	29.05.2025	Pershendetje, ISUV ofron sherbime per autokontroll vetem ne kuader te exportit. Listen e sherbimeve e gjeni ne linkun: https://isuv.gov.al/en/sherbime/ Faleminderit!	E Plote	0
5.	11.06.2025	aktualisht kultivoj sherebelë (Salvia officinalis) në Shqipëri. Po kërkoj të kryej analiza cilësie për sherebelën e korrur, veçanërisht për përmbajtjen e vajrave esencialë, pastërtinë, dhe standardet e nevojshme për tregtim apo eksport. (Jam i interesuar ne veçanti për vërtetim te produktit jo-GMO ose organik) Ju lutem më njoftoni nëse laboratorit juaj ofron	12.06.2025	Bazuar në kërkesën tuaj ju informojmë si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Llojet e analizave që ofroni Për matricen sherebelë e thatë ISUV kryen analizat e mëposhtme: 1-Përcaktimi i lagështisë. 2- Përcaktimi i përmbajtjes së yndyrës së përgjithshme me soxhlet. 3- Përcaktimi i indeksit të refraksionit të fraksionit vajor. 4- Përcaktimi i indeksit të refraksionit të fraksionit uJOR. 5-Përcaktimi i yndyrës së përgjithshme të fraksionit uJOR. 6- Përcaktimi i hirit të përgjithshëm.	E Plote	0

		<p>shërbime për analizimin e sherebelës së thatë. Do e vlerësoja nëse do mund të më informoni për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Llojet e analizave që ofroni • Kërkesat për mostrën dhe mënyrën e dërgimit • Çmimet dhe kohëzgjatjen e përpunimit • Nëse analizat tuaja përputhen me standardet e BE-së apo ndërkombëtar e 		<p>7-Përcaktimi i pastërtisë së sherebelës nëpërmjet refraksionit në 20 gradë celsius.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat për mostrën dhe mënyrën e dërgimit <p>Mostra duhet te jete e ambalazhuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çmimet dhe kohëzgjatjen e përpunimit <p>Kohëzgjatja e analizës është 7 dite pune dhe çmimi i analizës është 8900 leke</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse analizat tuaja përputhen me standardet e BE-së apo ndërkombëtare. <p>Metodat mbështeten në referenca ISO ndërkombëtare por nuk janë të akredituara.</p> <p>OMGJ është analizë e cila nuk ofrohet nga ISUV. Standartet e nevojshme per tregëtim dhe eksport është jashtë</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				kopetencave të ISUV. Certifikimi i produkteve jo organik është jashtë kopetencave të ISUV.		
6.	28.07.20 25	Ju lutem mund te kem nje the informacion cfare procedurash duhet te ndjek dhe cfare dokumentash duhet te bej tek institucioni juaj per te pevizur me qenin ne Gjermani/ Itali?	28.07.2025	Duke ju falenduar per pyetjen tuaj, ju informojme se Instituti i Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise nuk eshte institucioni kompetent lidhur me ceshtjen tuaj. Ju lutem drejtohuni prane Autoritetit Kombetare te Veterinarise dhe Mbrojtjes se Bimeve per te mare nje pergjigje me te sakte lidhur me kerkesen tuaj.	E pjesshme	0
7.	19.09.20 25	I nderuar/Zotëri i nderuar, Ne do të jemi në Shqipëri nga 06.01.2026 deri më 09.01.2026 për të marrë qenin tonë të adoptuar. Qeni plotëson të gjitha kërkesat e Bashkimit Evropian për udhëtim (mikroçip, vaksinim i vlefshëm kundër tërbimit, test antittrupash me periudhë	23.09.2025	I nderuar Zotëri, Ju lutemi të keni parasysh se ISUV nuk është autoriteti kompetent për shërbimin që po kërkon. Ju këshillojmë të kontaktoni Autoritetin Kombëtar për Mbrojtjen Veterinare dhe të Bimëve (AKVMB). Mund të vizitoni faqen e tyre zyrtare të internetit në: https://akvmb.gov.al/ .	E pjesshme	0

		<p>pritjeje tre mujore). Sipas rregulloreve të BE-së, kemi nevojë për Certifikatën Zyrtare të Shëndetit të Kafshës, dhe është e rëndësishme që ajo të jetë gati për të udhëtuar më 09.01.2026. Ju lutemi të na konfirmoni: Cila nga zyrat tuaja është kompetente për të lëshuar këtë certifikatë në Tirana? A është e mundur të caktojmë një takim më 07.01.2026 ose 08.01.2026 për lëshimin e certifikatës? Çfarë dokumentesh duhet të kemi gati për vizitën?</p>				
8.	16.10.2025	Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri,	24.10.2025	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 16.11.2022, është qendër kombëtare	E Plotë	0

		<p>po punon për realizimin e një artikulli për përdorimin e pesticideve në produktet shqiptare.</p> <p>Më qëllim realizimin e detyrës por dhe në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, kërkojmë të informohemi dhe të na vihen në dispozicion dokumente në lidhje me këtë veprimtari. Referuar ligjit nr 105/2016, përgjegjësia për veprimtaritë të cilat ne kërkojmë të dimë, është e juaja.</p> <p>Ndaj jemi të interesuar të kemi:</p> <p>1- Kontrolllet e kryera në 5-vjeçarin e fundit për</p>		<p>laboratorike përgjegjëse për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve në territorin e vendit.</p> <p>Sistemi i cilësisë në ISUV bazohet në normën ISO 17025:2017. Ky institucion kryen shërbime analitike për klientët që sjellin kampionet për t’i analizuar në laboratorët tanë. Klientët kryesorë të laboratorëve tanë janë AKU, AKVMB dhe në disa raste subjekte eksportuese.</p> <p>Bazuar në normën ISO 17025:2017, informacioni mbi rezultatet e analizave u dorëzohet vetëm klientëve që kanë dorëzuar kampionet, përveç rasteve alerte ku, njëkohësisht me klientin, njoftohet edhe Autoriteti Kompetent në MBZHR, i cili merr masa për zgjidhjen e problematikës në terren.</p> <p>Informacioni i kërkuar për periudhën 5-vjeçare, përmban të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve, përfshirë fermerë, ndaj trajtohet me kujdes të veçantë dhe mbrohet në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>PMB-të e regjistruara që janë hedhur në tregun shqiptar.</p> <p>2- Pesticidet e konstatuara nga analizat e kryera ndaj objekteve në 5 vitet e fundit</p>		<p>, i ndryshuar, si dhe me nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, i cili parashikon kufizime të së drejtës për informim në rastet kur publikimi mund të çënojë privatësinë dhe të dhënat personale të individëve. Po ashtu, në zbatim të nenit 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ISUV si autoritet publik ka detyrimin ligjor të mbrojtje të dhënave që lidhen me jetën private dhe aktivitetin profesional të subjekteve.</p> <p>Në këtë kuadër, e drejta për informim dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale janë të drejta të ndërlidhura ngushtësisht, ku respektimi i njërës nuk mund dhe nuk duhet të çënojë garantimin e tjetrës. ISUV, si institucion publik me funksione laboratorike dhe rregullatore, është i detyruar të veprojë në përputhje me këto parime dhe dispozita ligjore për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe</p>	
--	--	---	--	---	--

				<p>përdorimin e drejtë të informacionit që administrojnë.</p> <p>Për këto arsye, nuk mund t'ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar, pasi kjo e drejtë i takon vetëm klientëve të laboratorit dhe përputhet me legjislacionin përkatës.</p>		
9.	28.10.2025	<p>Pershendetje me duhet ta bjen test per origjinalitet te vajit ullirita kendi mundesi te me tregoni cfar duhet te bej etj faleminderit</p>	28.10.2025	<p>Përshëndetje,</p> <p>ISUV ofron shërbime për autokontroll vetëm në kuadër të exportit.</p> <p>Listën e shërbimeve e gjeni në linkun:</p> <p>https://isuv.gov.al/en/sherbime/</p> <p>Faleminderit!</p>	E Plote	0
10.	06.11.2025	<p>Te nderuar pershendetje,</p> <p>Ju shkruaj nga shoqata "Levizja per Zhvillimin e Turizmit" Ksamil, e regjistruar me vendim gjykate me vendimin nr: 5460 i dates 18.10.2016 dhe regjistruar ne QKB me Nipt/ L04329931S.</p> <p>Ne permbushje te detyres sone per te kontribuar nje nje turizem te qendrueshem ne zone duke shtuar vemendjen ne mbrojtjen e</p>	07.11.2025	<p>Përshëndetje,</p> <p>Duke ju falënderuar për interesimin dhe komunikimin tuaj, ju sqarojmë si më poshtë: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 16.11.2022, është qendër kombëtare laboratorike përgjegjëse për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve në territorin e vendit.</p>	E pjesshme	0

		<p>mjedisit, mbrojtjen e kultivuesve të midhjes dhe kultivuesve të mandarinave, kemi evidentuar qe nëpër media është përhapur lajmi, që mandarinat kanë dalë me përmbajtje të një pesticidi të ndaluar dhe të dëmshëm për jetën e njeriut.</p> <p>Media në raportim përmend që këto analiza i ka nxjerrë ISUV, ju, pa e përcaktuar qartë se nga është marrë kampioni për këto analiza, duke e lënë situatën në turbullirë.</p> <p>Si prodhuesit më të mëdhenjë në Shqipëri, zona jonë, e Konispolit, ka ndjerë efektin negativ të këtij lajmi që mund të jetë i vërtet por i pa përcaktuar se ku është kjo e vërtetë!</p> <p>Ne si shoqatë kemi mbledhur analizat që kanë bërë fermerët për secilin plantacion që ata kanë në prodhim dhe deri më tani nuk na ka rezultuar pozitiv me këtë pesticid.</p> <p>Për të ndaluar pasojat negative mbi fermerët e përgjegjshmën duke qënë se janë në sezon vjelje</p>		<p>Sistemi i cilësisë në ISUV bazohet në normën ISO 17025:2017. Ky institucion kryen shërbime analitike për klientët që sjellin kampionet për t'i analizuar në laboratorët tanë. Klientët kryesorë të laboratorëve tanë janë AKU, AKVMB dhe në disa raste subjekte eksportuese.</p> <p>Bazuar në normën ISO 17025:2017, informacioni mbi rezultatet e analizave u dorëzohet vetëm klientëve që kanë dorëzuar kampionet, përveç rasteve alerte ku, njëkohësisht me klientin, njoftohet edhe Autoriteti Kompetent në MBZHR, i cili merr masa për zgjidhjen e problematikës në terren. Për këto arsye, nuk mund t'ju vendosim në dispozicion informacionin e kërkuar, pasi kjo e drejtë i takon vetëm klientëve të laboratorit dhe përputhet me legjislacionin përkatës. Gjithashtu ju informojmë se referuar pikës d të nenit 10, të ligjit Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit " është dërguar pranë autoritetit kompetent lidhur me informacionin</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>dhe shitjet si dhe duke i dhënë siguri qoftë konsumatorit dhe grumbulluesve për cilësinë e produktit, ju lutem na sqaroni më me hollësi mbi analizat që keni kryer dhe ku janë marrë mostrat për analizat që kanë dalë pozitiv me pesticidin e ndaluar. Kjo do të na jap mundësi të përballemi me të vërtetën duke mbrojtur konsumatorin dhe fermerët. Na ndihmoni ta qetësojmë turbullirën dhe nëse ka lëmizhda në të ti pastrojmë.</p> <p>Në mbështetje të ligjit për të drejtën e informimit, jemi në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj.</p>		<p>që ju kërkoni. Faleminderit!</p>		
--	--	---	--	---	--	--

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk ka kërkesa për informacion për muajin Janar, Prill, Korrik, Gusht, Dhjetor 2025.